



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA  
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



**Emërtimi i lëndës: Didaktikë e Gjuhës së Huaj 2**

**Titullari / pedagogu i lëndës:** Prof. Dr. Elida Tabaku Dr. Vjollca Tabaku (Hoxha)

**Ngarkesa:** 4 kredite; 40 orë mësimore; 20 leksione /20 seminare

**Viti akademik/Semestri kur zhvillohet:** Viti III / Semestri II

**Lloji i lëndës:** E detyruar

**Programi i studimit:** Bachelor në Gjuhë Angleze

**Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës:** [elida.tabaku@unitir.edu.al](mailto:elida.tabaku@unitir.edu.al)

[vjollca.tabaku@unitir.edu.al](mailto:vjollca.tabaku@unitir.edu.al)

**OBJEKTIVAT E LËNDËS DHE REZULTATET E TË NXËNIT:**

*Objektivat e përgjithshme lëndore:*

- Lënda i pajis studentët me njohuri teorike dhe aftësi praktike për mësimin e gjuhës angleze në shkollën e mesme në përputhje me veçoritë psikologjike të moshës. Kryesisht përqendrohet në mësimin e katër aftësive të gjuhës, mësimin të fjalorit dhe testimit.
- Vëmendja përqendrohet në përdorimin e metodave të tilla që sigurojnë përvetësim aktiv të aftësive komunikative të gjuhës si dhe edukimin e strategjive të të nxënimit duke krijuar një mjedis nxitës për përvetësimin e gjuhëve nëpërmjet lojërave dhe veprimtarive gjuhësore.
- Nëpërmjet diskutimeve dhe mësimëve model studentët ekspozohen ndaj një shumëllojshmërie teknikash për menaxhimin e mësimin dhe mësimdhënies së fjalorit, gramatikës, kulturës. Lënda do ndihmojë në zhvillimin e mëtejshëm të aftësive gjuhësore të studentëve.

*Rezultatet e të nxënimit:*

Në fund të kursit studentët do jenë të aftë :

-të kuptojnë parimet dhe praktikën e mësimdhënies së gjuhës së huaj

- te trajtojnë mësimdhënien e gjuhës së huaj me entuziazëm dhe përkushtim
- të bëjnë zgjedhjen e duhur për teknikat e mësimdhënies të gramatikës,fjalorit,shqiptimin,kulturën, si dhe leximin,shkrimin,dëgjimin dhe të folurit.
- të përcaktojnë objektivat e arritjes dhe të ndërtojnë planin në përputhje me to
- të zgjedhë dhe të përpunojë material mësimor të përshtatshëm për nivelin dhe nevojat e klasës
- të kuptojnë parimet bazë dhe procedurat e ndërtimit të kurrikulës në bazë klase dhe niveli
- të kuptojë stilet dhe strategjitë e të nxënit dhe të përdorë teknika mësimdhënieje që nxisin strategjitë pozitive
- të përcaktojnë strategjitë më të përshtatshme për menaxhimin e klasës
- të vëzhgojë dhe analizojë procesin mësimor për të reflektuar dhe për t'u zhvilluar më tej nga ana profesionale